

URDHËR
Nr. 380, datë 22.12.2021

**PËR HAPJEN E THIRRJES SË KATËRT PËR APLIKIME PËR PROGRAMIN
IPARD II**

Mbështetur në ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”; në ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, të ndryshuar; në marrëveshjen kuadër, marrëveshjen sektoriale për IPARD II dhe Marrëveshjen e financimit,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e thirrjes së katërt për aplikime nga Programi IPARD II, për aplikimet, respektimin e kërkesave për informimin, publicitetin dhe transparencën, me qëllim garantimin e vizibilitetit dhe llogaridhënien e fondeve të BE-së.

2. Të gjitha palët e interesuara janë të lutura të marrin informacionin e duhur në udhëzuesin për aplikantët, lidhur me llojet e investimeve të pranueshme, aplikantët e pranueshëm, kriteret e përzgjedhjes dhe rregullat e dorëzimit të aplikimeve, i cili mund të kërkohej si një kopje e printuar (falas) në zyrat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR), gjatë orëve të punës 08:00–16:30, çdo ditë të hënë deri të enjte, dhe 08:00–14:00, çdo të premte.

3. Gjithashtu, udhëzuesi për aplikantët dhe formatet zyrtare të dokumenteve që duhet të përdoren (formulari i aplikimit, plani biznesit) mund të shkarkohen në versionin zyrtar nga data 10 dhjetor 2021, nga faqja e internetit: www.azhbr.gov.al, www.ipard.gov.al dhe www.bujqesia.gov.al.

4. Dorëzimi i aplikimeve fillon nga data 10 janar 2022 deri në datën 25 shkurt 2022, sipas orarit zyrtar 08:00–16:30, çdo ditë të hënë deri të enjte, dhe 08:00–14:00 çdo të premte. Çdo aplikim i mbërritur në AZHBR pas datës 25 shkurt 2022 do të refuzohet. Të gjitha afatet e mësipërme do të përlogariten, duke u bazuar në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

5. Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen vetëm në zyrat qendrore të AZHBR-së, në zarfe të mbyllura, me titullin “Thirrje për dorëzimin e aplikimeve”, së bashku me titullin e masës, emrin e plotë dhe adresën e aplikantit dhe me shënimin “Të mos hapet përpara dorëzimit”.

Aplikimet duhet të dorëzohen ose:

- nëpërmjet dërgesës postare rekomande; ose
- dorazi (duke përfshirë shërbimet korriere) direkt në Autoritetin Kontraktues në këmbim të një mandati dorëzimi me firmë dhe datë nga Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural Rruga “Muhamet Gjollësja”, nr. 56, Tiranë, Shqipëri. Aplikimet e dërguara nëpërmjet çdo mënyre tjetër (p.sh. me faks apo *e-mail*) apo të dërguara në adresa të tjera do të refuzohen.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Eranda Selmanaj